



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 334/5 Prot.

Tiranë, më 30 . 07 . 2015

V E N D I M

Nr. 81 , datë 30 / 07 / 2015

"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake nr. 1 Tiranë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, nenet 80 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin, Njësia Bashkiake nr.1 Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 35, datë 23.04.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake nr. 1 Tiranë*", vendosa, kryesisht, fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua në periudhën 04.05.2015 deri 08.05.2015, sipas programit të mbikëqyrjes, njoftuar institucionit me shkresën nr. 331 prot., datë 08.05.2015, "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me

shkresën 331/3, datë 01.07.2015, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e administratës vendore, Njësia Bashkiake nr.1, Tiranë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Në vijim të procesit, me shkresën nr. 2425/1, datë 07.07.2015, “Mbi projektraportin e mbikëqyrjes në Njësinë Bashkiake nr.1, Tiranë”, Njësia Bashkiake nr.1 Tiranë ka kthyer projektraportin e nënshkruar nga titullari i institucionit, së bashku me observacionet përkatëse në lidhje me konstatimet e grupit të mbikëqyrjes, si dhe aktet administrative që i mbështesin ato.

Pas analizimit të përmbajtjes së këtyre akteve, duke i krahasuar me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, vlerësoj se nga ana e institucionit është reaguar në lidhje me disa nga parregullsitë e evidentuara gjatë procesit të mbikëqyrjes.

Konkretisht, subjekti i mbikëqyrur ka ndërmarrë revokimin e akteve të konfirmimit të statusit të nëpunësit civil për nëpunësit të cilëve u është konfirmuar statusi i nëpunësit civil pas përfundimit të periudhës së provës, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pa ndjekur trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA); ka ngritur Komisionin Disiplinor; ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit për disa nëpunës në pozicionet përkatëse që ata mbanin në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Këto aspekte janë analizuar dhe paraqiten në mënyrë të detajuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, shoqëruar me argumentet përkatës, sipas rastit.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake nr. 1 Tiranë, që është pjesë e këtij vendimi.

2. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore të këtij institucioni, deklarimin e akteve të punësimit sipas përcaktimeve ligjore, si dhe shpalljen si vende të lira pune për pozicionet e plotësuara në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.

3. Njësia Përgjegjëse duhet të fillojë procedurën për revokimin e akteve si më poshtë:
 - Revokimin e urdhrit nr. 23, datë 05.03.2014, të Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë, me nr. 552 prot., datë 05.03.2014, për emërimin e ***** në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike*”.
Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit që vendin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike*” ta shpallë vend të lirë për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.
 - Revokimin e urdhrit nr. 44, datë 25.07.2014, me nr.1889 prot. datë 25.07.2014, të Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë, për emërimin e ***** , në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore*”.
Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit që vendin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore*” ta shpallë vend të lirë për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.
 - Revokimin e urdhrit nr. 27, datë 19.03.2014, me nr. 688 prot. datë 19.03.2014, të Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë, për emërimin e ***** , në pozicionin “*Ekonomiste në Sektorin e Burimeve Ekonomike*”.
Rregullimin e ligjshmërisë lidhur me nëpunësin ***** , duke e rikthyer atë në pozicionin “*Ekonomiste në Sektorin e Burimeve Ekonomike*” që mbante para daljes së urdhrit nr. 23, datë 05.03.2014, të Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë, me nr. 552 prot., datë 05.03.2014, për emërimin e ***** në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike*”.
 - Revokimin e urdhrit nr. 79, datë 02.12.2014, të Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë, për emërimin e ***** në pozicionin “*Specialist Infrastruktura në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban*”.
Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit që vendin e punës “*Specialist Infrastruktura në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban*” ta shpallë vend të lirë për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.
 - Revokimin e urdhrit nr. 117, datë 28.02.2014 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për emërimin e ***** në pozicionin “*Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve në NJBI*”.
Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit që vendin e punës “*Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve në NJBI*” ta shpallë vend të lirë për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.

- Revokimin e urdhrit nr. 46, me nr. 1891 prot., datë 25.07.2014, për emërimin e ***** në pozicionin “*Specialiste në Zyrën e Gjendjes Civile*”.
- Rregullimin e ligjshmërisë lidhur me nëpunësin ***** , duke e rikthyer atë në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile*” që ai mbante para daljes së urdhrit nr. 44. datë 25.07.2014, me nr. 1889 prot. datë 25.07.2014, i cili e emëronte në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore*”.
4. Institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe Departamentin e Administratës Publike, të qartësojnë pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil. Pasi të ezaurohet ky bashkëpunim, të vijnë procedurat lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Pavarësisht nxjerrjes së akteve të deklarimit të statusit të punësimit si “*nëpunës civil*” për nëpunësit ***** , specialiste në Zyrën e Gjendjes Civile, ***** , Specialiste në Zyrën e Gjendjes Civile dhe ***** , Përgjegjëse në Zyrën e Gjendjes Civile, ky proces duhet të përmbyllet pas verifikimit të procesit dhe plotësimit të kushteve të punësimit nga ana e këtyre nëpunësve në bashkëpunim me aktorët e mësipërm. Ky proces duhet të realizohet edhe për punonjësin ***** , në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi.
 5. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, të marrë masat që nëpunësit ***** , ***** , ***** , ***** , ***** të ndjekin trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), si dhe të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë para konfirmimit të tyre si nëpunës civilë.
 6. Njësia përgjegjëse të rishikojë dhe të plotësojë formularët e përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil duke patur si orientim modelin e miratuar me Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” (lidhja 4 bashkëlidhur këtij vendimi), si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”.
- Në zbatim të rekomandimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike, të hartohen përshkrimet e punës edhe për pozicionet e punës që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile.
7. Njësia Përgjegjëse duhet të marrë masa që vlerësimi i rezultateve në punë të realizohet për të gjithë nëpunësit që mbajnë pozicione pune pjesë të shërbimit civil, brenda afateve ligjore dhe të pasqyrojnë me objektivitet në hapësirat përkatëse komentet dhe shpjegimet e nevojshme për çdo nëpunës civil.

8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim, duke marrë parasysh se zbatimi i tij kërkon një kohë të kushtëzuar nga afatet procedurale të veprimeve që duhet të kryhen në këtë rast për rregullimin e situatës.
Zbatimi i këtij vendimi duhet të trajtohet i lidhur ngushtë edhe me veprimet që do të kryhen për implementimin e reformës në administratën vendore.
9. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim, duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
10. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbi zbatimin e këtij vendimi.
11. Për këtë vendim të njoftohet Njësia Bashkiake Nr. 1, Tiranë, Bashkia Tiranë, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA